REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr.721 Prot

Maliq, më 10.2.2026

VENDIM

Nr.23 datë **10.02.2026**

"Për detajim dhe përdorim të fondit për mbrojtjen civile (nga fondet e veta) "

Në mbështetje të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 54 "Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak" gërma (dh) , Ligjit nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", ligjit nr.68,datë 27.04.2017 "Për financat e qeverisjes vendore", Vendimit të Këshillit të Bashkisë me nr.3,datë 08.01.2026 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2026", Urdhërit të Komandës Mbështetëse pranë Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura me nr.86, datë 30.01.2026 "Për përmirësimin e kalueshmërisë në aksin Maliq-Lozhan, Gjinikas, Osojë, Bashkia Maliq" me prpozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshillit Bashkisë :

VENDOS :

1. Detajim dhe përdorim fondi nga Emergjencat Civile **(fondet e veta)** të parashikuara në buxhetin e vitit 2026 për mbulimin e shpenzimeve për mjetet dhe punonjësit e Ministriasë të Mbrojtjes, Komanda Mbështetëse për dy segmente rrugorë :
   a) "Segmenti rrugor nga Diga e HC Moglicë –Peshtan, Protopapë" për shumën 1,037,500 lekë sipas detajimit dhe zërave nga Komanda Mbështetëse
   b) "Segmenti rrugor nga Tre Urat Lozhan -Fshati Mesmal për shumën 1,037,500 lekë e detajuar sipas zërave nga Komanda Mbështetëse.

Pakësim *në 000/lekë*

Gr.	Kap.	Kod. Prog.	Llog.Ek.	Kodi Objekti	Objekti	
00	05	03280	606	9999999	*Mbrojtje Civile*	**2,100**

Shtesë

Gr.	Kap.	Kod, Prog.	Llog.Ek.	Kodi Objekti	Objekti	
00	05	04520	602	9999999	'Shpenz oper. rehab. rrugë'	**2,100**

2. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Sektori i Emergjencave Civile dhe Njësitë Administrative Gorë dhe Moglicë .
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Miratuar më 17 vota

Vota Pro 17

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur më 10.02.2026

KRYETARI I KËSHILLIT

ORNILDI DEMOLLARI

